

RILINDASI

Viti III - Nr:14

E diel, 7 prill 2013

Kryeredaktore: Admirina PEÇI

Na ndiqni
edhe
online

WWW.SHQIPTARJA.COM

PUSHTIMI I SHQIPERISE

Komunizmi e çeli derën më 7 prill 1939

YLLI POLOVINA

Duke qenë personalisht i bindur se pushtimi fashist italian jo vetëm i rrëmbeu sovranitetin shtetit 27 vjeçar shqiptar dhe i këputi në mes, me një goditje të rëndë e kriminale, krejt zhvillimin e tij normal, por u shndërrua edhe në gjeneratorin kryesor të ushqimit, rritjes dhe fuqizimit të lëvizjes komuniste prosovjetike në vendin tonë. Ishte Roma fashiste ajo që po e ndihte, edhe pse në mënyrë të pavetëdijshme e duke kujtuar se po e luftonte, ardhjen e shpejtë të Moskës në Shqipëri. Përpara asaj shtypte që i dha pushtimi këtij procesi, roli për të njëjtin qëllim i grupeve komuniste në Korçë, Shkodër apo Tiranë, e kudo gjetkë nëpër qytetet tona, përbën një faktor fare të pallogaritshëm.

Në këtë aksion paradoksal u gjend edhe Ahmet Zogu, politikan i antikomunizmit e kishte



NË FOTO: (Majtas) Martesa e mbretit Zog me Geraldina Apony (Lart) Benito Musolini gjatë vizitës së tij në Shqipëri, maj 1941. Motivi për tu dhënë kurajo ushtarëve italianë gjatë luftës Italo-Greke dhe Autokolona e ushtrisë fashiste drejt kryeqytetit, prill 1939

Ja çfarë simbolizon vallja tipike e popullsisë arbëreshe

Vallja është një kërcim me motive popullore, ritmike që shoqërohet nga një kor duke kënduar një këngë të vjetër tradicionale arbëreshe, me origjinë ballkanike. Vallja po-

pullore arbëreshe gjatë viteve është një event popullor që luhet të martën e Pashkëve për vendet me ritin bizantin dhe Karnavaleve për vendet e ritit latin. Me kalimin e shekujve në disa zona,

vallja ka marrë edhe pak nga motivet e valles kalabreze "Tarrantella". Vallja luhet në rreth, ku grupe grash të veshura me kostume madhështore ku të gjitha hedhin në njëta... [faqe 19](#)

shndërruar jo vetëm në ideologji të mbretërimit, por edhe në instrument aktiv të pushtetushtrimit. Një aksion i shpejtë arrestimesh i radikalëve të majtë, në gjysmën e dytë të muajit dhjetor 1938 dhe që mori formë publike në 14 janar 1939 me botimin në shtypin e Tiranës e dekretit të porsafirmosur nga monarku mbi emërimin e trupit gjykues të Gjyqit të Posaçëm për Fajë Politike, bëri bujë dhe po aq jehonë. Çuditërisht kjo pati ngjarë vetëm tetë ditë më vonë nga çasti kur Benito Musolini hodhi mbi letër një firmë tjetër, kobze: mirato planin e ministrit të Jashtëm dhe dhëndrit të tij Gaetano Ciano për pushtimin e Shqipërisë. Gjyqi spektakël kundër komunistëve u përpoq të mbulonte atë që në të vërtetë ziente brenda raporteve të mbretit jo me Bashkimin Sovjetik, i cili në këto raste për Shqipërinë nuk tregonte ndonjë interes të veçantë, por me Italinë. Lexuesi e di fare mirë që... [vijon në faqen 14-15](#)

Kongresi i Triestes, "Shqipëria kufi deri në Bullgari"

Dita e tretë e Kongresit mbajtur nga 1 deri në 4 mars 1913. Pjesëmarrësit diskutojnë sërish çështjen e kufinjve krahas çështjeve të tjera, por Konica i kundërshton duke thënë se kjo çështje është mbyllur

E TRETË DITË.

Mledhja e paradites. Fillohet e treta ditë me këndim t'telegramit t'E.T. kondit Berchtold: "Faik Konika, President i Kongresit Shqypëtar, Triesthtë - Shum i kenaqun per ndjesiina t'diftuemeu n'telegram q' m'dergove n'emën t'Shqypetarve t'mledhun n'Kongres n'Triesthtë, t'lutem me pelqye bashkë me falenderjet e mija urimet mara t'mdhajat per perparim t'Shqypëniis e t'popullit shqyptaar. Berchtold". Me brohoriina t'mdhaja pershndetet ky telegram. At Fan Noli shqypëton nji t'folun qi e myllë çashtjen e kufive. Ai me shum arsyena historike, etnike, ekonomike, difton se Shuypëniija do t'formohet

sadopak prejë kater vilajeteve t'Shkoders, Janinës, t'Kosovës e t'Monastirit. Edhe këso heret uratori asht fort i aklamuem. Mbas kësajë, Kol Ivanaj i avitet presidencës e i lypë Fajk Konicës shvillim per mëndirë t'keqe qi dje ja priti fjalën. Faik Konica i përgjegjë se s'e kaa me detyrë me dhanë shvillim kurrfare, pse at herë gjithçilli Kongresist do t'jepte ndo i zhvillim, atëherë Ivanaj holl mbii tries t'presidencës biljaten me emën t'vet. Kjo ngjarje nuk shkoj gjatë. Faik Konica i dha, për mjes dy tjerve, nji diftim, ku, pas permendë kerkend, thote se kama e tij si kreitar, qi lypë nji paansii kreit t'keputun, e vën jashta...

[faqe 18-19](#)



Kaçorri, Perandorit Franz Josef: "Mos lejoni coptimin e Shqipërisë"

Dokumentet dëshmojnë se nuk ka shqiptar më idealist e patriot se Imzot Nikoll Kaçorri, e megjithë këtë u la në harresë për 94 vjet, dhe veç kësaj dhe kur u gjetën eshtrat e u kthyen në atdhe pushtetarët e anashkruan, e injoruan

NGA PJETER LOGORECI

[faqe 16-17](#)

Çatin Saraçi, i famshëm në Angli, i panjohur në Shqipëri

Ky piktor, prej kohësh kishte emigruar në Londër dhe atje me punën e vet tejet të zellshme kreative, u bë emër shumë i njohur në artet pamore. Mirëpo, në Shqipëri krijimtaria e tij nuk njihje fare

MR. BISLIM ALIU

S'do mend se largimi i S'çdo krijuesi nga vendlindja dhe vendosja e tij në ndonjë vend të huaj, në diasporë, është pa dyshim humbje e madhe për çdo vend. Atje krijuesi shkon, sigurisht, me mallin e vendit, të familjes dhe të shoqërisë në përgjithësi. Dhe, sigurisht, nostalgia e krijuesit për vendlindjen, asnjëherë nuk mund t'i largohet nga memoria. Ndaj, medemos, kjo nostalgji e tij për vendlindjen e vet, është gjithnjë prezente në krijimtarinë e gjithmbarshme të secilit krijues. Zaten, kjo dukuri është e njohur edhe nga historia e artit, e cila na tregon dendur për shumë krijues që

kanë emigruar në një vend tjetër. Ata, pra, gjithnjë mbetën me origjinën e vet, me mallin për vendlindjen me shpirtëroren dhe me ndiesinë e bukurinë e vendit të vet. Dhe, mu për këtë, për ndiesinë dhe për shpërfaqjen tejet të rezonuar në krijimtarinë e treguar dhe për nostalgjinë e rëfimit përmbajtjesor, mund t'i përmendim tre krijues që vazhdimisht krijuan në metropolet botërore, e asnjëherë nuk u shkëputën nga atdheu i tyre. Pa mëdyshje, me krijimtarinë e vet Shagalli në të vërtetë, shkëlqeu në Paris, por gjithnjë ruajti shpirtin dhe nostalgjinë ruse; Pikaso krijoi shumë vite në Paris, mirëpo, si gjithnjë ndjehet...

[faqe 20](#)

PATRIOTI | I MADH


NGA PJETER LOGORECI

Këto ditë po shihja me andje në një emision televiziv, zhvillimin e ceremonisë solemne për riatdhesimin e rivarrimin e eshtrave të ushtarakut student, patriotit Shahin Toci, sargu i të cilit u prit në aeroportin e Rinasit me 26 mars 2011, me shumë nderime, ashtu sic e meritonte ky djalë trim që i qëndroj besnik deri në flijim flamurit tonë kombëtare.

I pushtuar nga emocionet e pamjeve nga ceremonia, ku shihje dhjetra njerëz që valvitnin ndër duar flamurë kombëtare, dalloje në qëndrim nderimi, ministra e personalitete të shtetit të veshur me uniforma shumëngjyrëshe në homazh të këtij trimi lirisdashës, po mendoja se pothuajse para një muaji (me 9 shkurt 2011) zbrita nga avioni i linjës Eien-Rinas po me të njëjtin qëllim, për të riatdhesuar pas 94 vjetesh eshtrat e DOM NIKOLL KACORRIT - ARKITEKTIT TE PAMVARSISE E TE SHTETIT SHQIPTARE që gëzojmë sot, por me një ndryshim të madh, se atë ditë "te zeze për ndjenjën kombëtare", sargun me eshtrat e titanit nuk e priste asnjë personalitet, ministër, gjeneral, zv/minister apo drejtor drejtorie... bile as edhe një klerik i lartë. Sytë mu mbushen me lot dhe tërë qenien time ma pushtoj një ndjenjë keqardhje dhe turpi.

Me ditë të tëra isha munduar të lajmeroj për ardhjen e eshtrave të Imzot Kacorrit, personat përgjegjës të shtetit, që nga institucionet më të larta, ministratë, kuvendin, deputetët e Durrësit, hierarkinë e lartë kishtarë të dioqezës së Tiranë - Durrësit, me telefon e po ashtu me postë elektronike. Asnjë reagim. Situata e krijuar më solli ndër mend që veprimi im nuk i sillte kujt ndonjë përfitim ekonomik (për të cilin do te ishin prezent të gjithë ato persona që përmenda më sipër), por ishte vetëm një veprim moral e patriotik për të cilin më ishin përgjegjës njerëzit e thjeshtë të ardhur në grupe nga Durrësi e Lura.

Çfarë paradoksi. Një burrë i madh, etalon i patriotizmit, lirisë dhe atdheadashurisë, prift katolik i cili kishte deklaruar me gojë e tij... "për mua së pari atdheu mandej kisha...", nuk u vlersua, ose u la në harresë me dashje, ashtu sikurse u la në harresë për 94 vjet në



NË FOTO: Letër e formular dhe e shkruar nga Imzot Kacorri drejtuar Perandorit Franz Josef në Vjenë, në fund të të cilës dallojnë firmat e drejtuesve të komitetit të përgjithshëm të Shqipërisë së mesme

DOM NIKOLL KAÇORRI

Letër Perandorit Franz Josef

“Mos lejoni coptimin e Shqipërisë”

Dokumentet dëshmojnë se nuk ka shqiptar më idealist e patriot se Imzot Nikoll Kaçorri, e megjithë këtë u la në harresë për 94 vjet, dhe veç kësaj dhe kur u gjetën eshtrat e u kthyen në atdhe pushtetarët e anashkaluan, e injoruan

dhe të huaj. Perse duhej që aktiviteti i tij të shihej vetëm nën petkun e priftit katolik, që të pasojë me një sjellje të tillë? Apo kaq e madhe ishte propaganda komuniste kundër këtij atdhetari sa që njerëzit vazhdonin ta shihnin si "klerik reaksionar".....???

Dëshëroj të sjell me poshtë për lexuesit një dokument original të gjetur në arkivën e ministrisë së jashtme në Vjenë, ku çdo njeri edhe ato me skeptikët mund të shohin e të binden për punën e madhe që Imzot Nikollë Kacorri bëri në dobi të atdheut të robëruar nga hordhitë aziatike osmane.

Letër perandorit

Shum të vështrira e të rrezikshme janë këto ditë për ne Shqiptarët e per nanën t'on Shqypninë që të kater shtetet e Ballkanve po rraim me e perpië a me e coptue. Na me së fuqije kena mundohena edhe Përendisë i lutena qi Mbretnia jon të muisi këta anmiq e të na prui prej sish. Por per fat të keq gjasat nuk po na duken fort të mira...

Dokumenti mban datën 12 nandor 1912 dhe është një letër e shkruar dhe formular nga Imzot Kacorri, e cila i drejtohet Perandorit Franz Josef të parë në Vjenë, për ta vënë në dijeni që: shqiptarët nuk e durojnë më robërinë. Ato duan tashmë pavarësinë, të drejtën e shkollave, kulturës, traditave e gjuhës së tyre. Ato kërkojnë përmes kësaj letre, mbështetjen e perandorisë më të madhe të kohës për të mos lejuar coptimin e Shqipërisë nga vendet fqinje në Ballkan.

Madhnisë të Ti
Franz Josefit I

Perandorit e Mbretit të Austro - Magjarisë në Vjenë Shum të vështrira e të rrezikshme janë këto ditë për ne Shqypnarët e per nanën t'on Shqypninë qi të kater shtetet e Ballkanve po rraim me e perpië a me e coptue. Na me së fuqije kena mundohena edhe Përendisë i lutena qi Mbretnia jon të muisi këta anmiq e të na prui prej sish. Por per fat të keq gjasat nuk po na duken fort të mira, e po shohim se shum vende të kater vilajeteve të Shqypnisë, Kosovë, Manastir, Shkodër e Janinë gjinden nden kambë të hueja.

Per këtë shkak po marim lejen m'u sjelle kah

Madhnia Jote si Përandorit të një Përandorisë të madhe, qi asht ma e afërma e jon e ka piesë në Ballkan me Bosnie - Herzegovinë, e me Julutun qi në çeshtjet të Ballkanve të merret para syshë edhe Shqypnia në mënyrë qi kufit e sajë mos të bërkten e mos të shtyhen prej kerkui e qi Shqypnia kështu e pa bërkame e e pa vogluëme të ketë një Automië të plotë nden Mbretinë Otomane.

Por në kioftë se per fat të zië qillon, qi kio Mbretinë nuk ka me muit ma mbas luftesë të sotshme me sundue në kurrfar mënyre Shqypninë, na nga thelbi i zembrës i lutena Madhnisë

s'ate qì Shqypnia prej kater vilajetesh permendun sipri me tre milion e sà Shqyphtarë të bahet një Mbretinë në vëhte sikurse të tjerat shtete të Ballkanve, në daç perse Shqyphtarët jan një kambë ma i vjetri ner këta, me një gjuhë e me zakone fare të veçanta, e gjaku i tyne nuk mundet me paitue kurrsesi me çdo gjak të kombëve qì jan rreth e rrotull; në daç perse nuk do t'ishite e drejtë humbja as voglimi i një kombi Shqyphtarë, i cilli nuk është aspak ma i poshtem se kombët e tjera të Ballkanve si per numer, ashtu per mendë, si per vjeften morale, me të cillën, sado qì per një kohe shekuish shum të gjatë kje rrahan në çdo krah e në çdo mënyrë prej shum e shum tallazeshë politike qindroi në kombësië të vet e në zakone të veta, por si një shkambë i fort në mjedis detit; e kjarishtë e distoin edhe theroritë e mëdhaja qì Shqyphtarët hoçen per rain, gjyterimin, e perparimin e Kombit të vet në këtë kohe të mramë të Tyrqëvet të Rie: në daç edhe perse na duket se një Mbretinë Shqypitare mban peshën jo vetem të Ballkanve, por edhe të gjith shteteve t'Europës, e sidomos në mujt m' u baa, mbas dishirit t'on, një mbretinë e pa anë (neutre), sikurse Belgji e Sviizzera.

Prej gjith këtyne shkaqeve e arsyanave na e pështhesim të tanë shpresën t'one në ma të madhen mirsine e Madhnisë Tandë per të cillën na e gjith kombi Shqyphtarë ka per të Jau ditun per nderer per gjithmonë.

Me shpresë të madhe qì të lutunat t'ona kam me e bërka zembrën e Madhnueshme të Madhnisë Tandë kemi nderjen ma të madhen me vuë këtu duert t'ona e m' u permendun.

Shqypnië, 12 Nanduer 1912


Te Detyrushmit Sherbëtorë te Madhnisë s'ate

- Firmat
- Nikoll Kaçorri Prift
- Mustafa Asim Kruja
- Reaçep Mitrovica
- Fuad Toptani
- Abdi Toptani
- Murad Toptani
- Salih Gjuka Ipek
- Bedri Pejani

Letra është e shkruar në tri faqe. Ajo është e firmosur nga drejtuesit kryesorë të komitetit të përgjithshëm kryengritës së Shqipërisë së mesme: Nikoll Kaçorri, Fuad Toptani, Murad Toptani,



NË FOTO: Familjarë të Imzot Kaçorrit dhe qytetarë durrëske pranë sargut të tij në Rinas



NË FOTO: Letra e konsullit Rudnay për ministrinë e jashtme në Vjenë

Abdi Toptani, Mustafa Kruja, Rexhep Mitrovica, Salih Gjuka, Bedri Pejani, Mustafa Kruja. Letra i është dorëzuar Konsullit Austriak në Dur-

rës Rudnay, i cili së bashku me letren, dërgon një ministrinë e jashtme në Vjenë, personalisht për ministrin e jashtëm Leopold Grafen Berchtold me shënimin "shumë konfidencial", një përshkrim për gjendjen e vështirë dhe shpërthyesë, të krijuar në zonën e Shqipërisë së mesme.

Në shënimin e tij Rudnay shkruan: mbasi unë pashë qëndrimin e palëkundur të popullit, i cili pretendon të bëhet një kongres për shkëputjen e vendit nga perandoria dhe kërkon përjashtimin e të deleguarve të huaj nga Mutesarifat në kongres, po ashtu dhe pasi dëgjova pretendimet e orthodoxeve të cilët kërkojnë një pushtet të huaj që të mos sundohen më nga shumica musulmane, vendosa me iniciativën time të marr për sipër, me kërkesat më të pranueshme për ne, këte letër që sollën të deleguarit.

Në një bisedë që pata me famullitarin e Durrësit Don Nikoll Kaçorri dhe Murad Bey Toptanin i theksova atyre që Monarkia mbron interesat e Shqipërisë pa e pushtuar atë, e dëshëron që shqiptarët në këto kohë të vështira të bashkohen me njeri tjetrin. Gjatë bisedës i tregova atyre edhe motivet kryesore të mbështetjes tonë. Gjatë ditës kam marrë nga Don Kaçorri, në mirëbesim, letër me kërkesa për Madhërinë e tij, ku sipas këshillës sime u hoqën disa pika të pakup-

timta. Murad Topatani, të cilit i detyroheshja ti ktheja një vizitë më konfidoi më vonë që delegatët tremben se kongresi do të dëshëtojë, e kanë vëndosur menjëherë ti dërgojnë madhërisë së tij këtë kërkesë. Sapo i hodha një sy letërës, pashë që të gjithë delegatët kishin pranuar, ato çfarë kishim diskutuar me Don Kaçorrin. Aty kërkohej autonomi e vendit, por nën sundimin turk, e po qe se kjo është e pa mundur, atëherë të kërkohej Pamvarësi dhe Neutralitet. Unë jam munduar që letra të stilizohej në mënyrë që të kishte hapësira për ndryshimet e mundëshme (për të përjashtuar ndikimin e fuqive të tjera), pa cënuar angazhimin tonë. Pas dorëzimit të kësaj letre, kam bërë marveshje, që unë nuk do të përdor ndikimin tim në Kongres dhe nuk do të marr për sipër asnjë ndërhyrje aty. Gjithashtu kam konfirmuar që për sa kohë të zgjasë Kongresi dhe ndikimi turk në vend, do pranohet të bisedoj apo veproj vetëm në mënyrë konfi-

timta. Murad Topatani, të cilit i detyroheshja ti ktheja një vizitë më konfidoi më vonë që delegatët tremben se kongresi do të dëshëtojë, e kanë vëndosur menjëherë ti dërgojnë madhërisë së tij këtë kërkesë. Sapo i hodha një sy letërës, pashë që të gjithë delegatët kishin pranuar, ato çfarë kishim diskutuar me Don Kaçorrin. Aty kërkohej autonomi e vendit, por nën sundimin turk, e po qe se kjo është e pa mundur, atëherë të kërkohej Pamvarësi dhe Neutralitet. Unë jam munduar që letra të stilizohej në mënyrë që të kishte hapësira për ndryshimet e mundëshme (për të përjashtuar ndikimin e fuqive të tjera), pa cënuar angazhimin tonë. Pas dorëzimit të kësaj letre, kam bërë marveshje, që unë nuk do të përdor ndikimin tim në Kongres dhe nuk do të marr për sipër asnjë ndërhyrje aty. Gjithashtu kam konfirmuar që për sa kohë të zgjasë Kongresi dhe ndikimi turk në vend, do pranohet të bisedoj apo veproj vetëm në mënyrë konfi-

denciale. Nga delegatët të cilët kanë nënshkruar këtë dokument, vetëm Mithat Frashëri ka nënshkruar menjëherë, por edhe të tjerët nuk kanë vonuar ta nënshkruajnë. Së fundi dëshëroj të ju bëj të ditur shkelqësisë tuaj, që zotërijtë presin të marrin nga ju një pergjigje të pranueshme. Si gjithmonë me lejen tuaj, arrita të ndikoj sadopak pozitivisht në Kongres. Edhe një herë dëshëroj të ju bëj të ditur se kam vendosur, nëq Kongresi i Shqiptarëve do të pengohet, të kërkoj nga Elita e shqiptarëve një dokument, i cili nuk do na sjellë detyrime anës tonë, që do të mund ta perdorim në situata të vështira që mund të krijohen.

Kuptohet qartë se interesat tona kombëtare, ato të Dom Nikollës përputheshin me ato të Austro-Hungarisë, e cila kerkonte që influenca e saj të shtrihet në tërë Ballkanin. Kjo ishte arsya qe konsulli Rudnay mbante kontakte të ngushta me atdhetarët shqiptare, të cilët morën për sipër misionin që të njoftojnë fuqitë e medha se populli shqiptar do ti merrte armët në dorë për ti dale zot territorëve të veta. Dera e Dom Nikolle Kaçorrit ishte kurdoherë e hapur për atdhetarët. Aty bëheshin mbledhjet e komitetit e ndërmerreshin vendime të rëndësishme për lëvizjen popullore.

Dëshëroj të mbyllë shkrimin tim me fjalët e Mustafë Krujës: Shqipëria për Dom Nikollë Kaçorrin, Atdheu, lirija e saj ishte ideali i tij... Dom Nikolle Kaçorri ishte shqiptar me plot gojen... e deri më sot, s'më ka rënë të këndo gjkund ndonjë rresh që ta përmendi sado për keq emrin e tij, megjithëse ka qënë përkrah Ismail Qemalit në Vlorë, edhe nënkryetar i denjë i së parës qeveri shqiptare, i zgjedhur prej atij kuvendi kombëtar, që shpalli pamvarsinë e atdheut, dhe që mundi të krahasohet për rëndësinë e tij historike, vetëm me Kuvendin e Lezhës... gati pesë shekuj më pare.

Wien, 4 prill 2013

PROVIMI I GJUHËS ITALIANE P.L.I.D.A. JEPET MË 29.04.2013, NIVELI (B2)
 I vlefshëm për studime dhe punësim në Itali njohur nga ambasada italiane
 www.plida.it

Rregjistrimi të qendra "Dante Alighieri" | Fakulteti i Gjuhëve të Huaja; Rruga: "Elbasanit" | Profesor: Artur SULA Tel: +355 (0) 67 27 89 969

PORTRETI | I PIKTORIT



Gjela Deti, tablo e Çatin Saraçi



Varka të lidhura, tablo e Çatin Saraçi



Portret i Çatin Saraçi realizur nga Oskar Kokoschka, Londër

ÇATIN SARAÇI

I famshëm në Angli, i panjohur në vendin e tij

MR. BISLIM ALIU


S'do mend se largimi i çdo krijuesi nga vendlindja dhe vendosja e tij në ndonjë vend të huaj, në diasporë, është pa dyshim humbje e madhe për çdo vend. Atje krijuesi shkon, sigurisht, me mallin e vendit, të familjes dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Dhe, sigurisht, nostalgjia e krijuesit për vendlindjen, asnjëherë nuk mund t'i largohet nga memoria. Ndaj, medoemos, kjo nostalgji e tij për vendlindjen e vet, është gjithnjë prezente në krijimtarinë e gjithmbarshme të secilit krijues.

Zaten, kjo dukuri është e njohur edhe nga historia e artit, e cila na tregon dendur për shumë krijues që kanë emigruar në një vend tjetër. Ata, pra, gjithëherë mbetën me origjinën e vet, me mallin për vendlindjen me shpirtëroren dhe me ndiesinë e bukurinë e vendit të vet. Dhe, mu për këtë, për ndiesinë dhe për shpërfaqjen tejet të rezonuar në krijimtarinë e treguar dhe për nostalgjinë e rrëfimit përmbajtjesor, mund t'i përmendim tre krijues që vazhdimisht krijuan në metropolet botërore, e asnjëherë nuk u shkëputën nga atdheu i tyre. Pa mëdyshje, me krijimtarinë e vet Shagalli në të vërtetë, shkëlqeu në Paris, por gjithnjë ruajti shpirtin dhe nostalgjinë ruse; Pikaso krijoi shumë vite në Paris, mirëpo, si gjithnjë ndjehet spanjoll, e Van Gogu jetoj dhe krijoi në Paris, mirëpo asnjëherë dhe askurrë, nuk e harroi identitetin holandez.

Mirëpo, në këtë rrjedhë të emigrimeve dhe ruajtja e nostalgjisë për vendlindjen e vet, edhe ne, që me kohë patëm krijues të mirëfilltë që morën rrugën e diasporës. Dhe, le t'i përmendim vetëm disa nga ata që lanë gjurmë të pashlyera në krijimtarinë e vet artistike. E në mesin e tyre ishin: Mark Bazaiti, Viktor Karpaçi, Andrea Aleks, Mikel Trota, Abedin Dino, Vera Biloshmi, Ibrahim Kodra, Gjelo Gjokaj, Daut Berisha, e ndonjë tjetër, që vazhdimisht dhe përherë treguan përkushtimin dhe rezonancën e lartë nostalgjike, në krijimtarinë e gjithmbarshme të tyre artistike. Ata këtë madhësi kreative e treguan me mburrje dhe me krenari.

Megjithatë, rasti më tipik dhe



Çatin Saraçi

do të thosha më eklatant është piktori Çatin Saraçi. Dihet mirëfillt se ky piktor, që me kohë kishte emigruar në Londër dhe atje me punën e vet tejet të zellshme kreative, u bë emër shumë i njohur në artet pamore. Mirëpo, në Shqipëri fare nuk njihet krijimtaria e tij. Pra, do të thoshim, shumë i njohur në Angli, por i panjohur në vendin e tij. S'do mend se fillat e para për njohjen e tij, pa mëdyshje, ishin nga albanologu anglez, Liam Medvall, i cili e botoi një kartolinë

nga "The Pride Gallery" ku paraqiti për herë të parë tablo të bukura të piktorit Çatin Saraçi. Tevona të dhëna të konsiderueshme për këtë piktor u morën edhe nga bashkëkohësit e Çatinit, Dërvish Dumës dhe Ihsan Toptani. Këta të dy me vendosmëri treguan për pikturën dhe besa edhe për krijimtarinë e veçantë të piktorit Saraçi.

KRIJIMTARIA E BUJSHME E PIKTORIT

Gjithsesi, krijimtaria e gjithm-

barshme e piktorit Saraçi ishte tejet e lartë, ku shpërfaqje kreative tejet të rezonuar i një rrëfimi idilik, nostalgjik dhe mbasë të një rrëfimi rezonues dhe tejet përmbajtjesor.

Është e dijsme se piktori Çatin ishte i martuar me një angleze e quajtur Elizabet Milburn. Dhe, pas vdekjes së piktorit, e tërë krijimtaria e tij i mbeti gruas së tij. Milburn gjithnjë ankohej, se si është e mundur që askush nga Shqipëria, fare të mos interesohet për krijimtarinë shumë të bujshme të bashkëshortit të saj.

Mandej ajo dëshironte që ta vizitonte Shqipërinë dhe kishte dëshirë shumë të madhe, ta prisnin si një bashkëshorte të një piktori të madh shqiptar. Ndaj, këtë dëshirë, ajo e ruajti me një xhelozji të madhe. Shtëpia e saj ishte në krahinën e Njo Portit, e cila është një galeri e vërtetë. Aty ruhet e gjithë krijimtaria figurative e piktorit Çatin. S'do mend se në dhomat e shtëpisë të saj janë të vendosura punimet me ngjyra vaji, pastel, akuarel, ku ishin të realizuara në kohë të ndryshme. Gjithsesi, opusi i gjithmbarshëm ka një vlerë të lartë të rrëfimit dhe ai opus numëron afro 300 vepra.

NXËNËS DHE MIK I NGUSHTË I OSKAR KOKOSHKËS

Aty kah viti 1933, piktori Çatin takohet për herë të parë me piktorin austriak Oskar Kokoschka në Vjenë të Austrisë. Dhe, sigurisht, kontaktet e përhershme me të e detyruan që të bëhet nxënës i tij për një kohë të shkurtër. Dhe shumë shpejt edhe krijuan një miqësi të jashtëzakonshme. Interesimi i shtuar i piktorit Çatin, për ta perfeksionuar pikturën dhe besa, edhe drejtimin e ekspresionizmit, tregoi dendur për talentin e

jashtëzakonshëm në pikturë. Në vitin 1945 Saraçi e hapi ekspozitën e parë në Refren Gallery. E, fjalën e rastit e mbajti mësuesi dhe piktori Kokoschka. Gjithsesi prezantimi i piktorit Saraçi me vepra të nduarnduarta tregoi qartas kreativitetin e lartë për shpërfaqje tejet të rezonuar të rrëfimit përmbajtjesor. Zaten edhe fjala e mbajtur dhe vlerësimi i Kokoshkës për ekspozitën e organizuar s'do mend se ishte tejet i lartë. Dhe, në shenjë respekti për piktorin, piktori Kokoschka ia bëri një portret që gjithsesi tregon miqësinë e lartë që kishin në mes vete.

PIKTOR I VLERËSUAR

Në përgjithësi, kritika angleze e ka vlerësuar shumë lart krijimtarinë e piktorit Çatin Saraçi. Andaj, në mesin e shumë të tjerëve, për një vlerësim tejet të lartë dhe mjaft bindës, mund ta përmendim kritikun e artit, J. P. Hodin, i cili e jep këtë vlerësim për piktorin shqiptar: "Penel pas peneli Saraçi i vendos tonet e qarta të ngjyrave të tij derisa arrin vlera të cilat nuk gjenden në asnjë tubet dhe janë harmonia poetike të një koloriti të rrallë. Ato kanë aromën e lulëzimit, ëmbëlsinë e frutave..."

Pa mëdyshje, në punimet e para të piktorit Çatin vërehet dukshëm një ndikim i përafërt me O. Kokoshkën. Megjithatë, më vonë, në punimet e tij, gjithsesi vërehet një qasje e re, të një arti të formuar dhe me një individualitet të theksuar të rrëfimit. Megjithatë, figura e Çatinit, është e njohur edhe jashtë fushës së artit. Ai përherë ka bërë edhe korrespondencë me Faik Konicën, Edith Durham dhe me personalitet të tjera të shquara. Pra, figura e piktorit Çatin Saraçi, gjithsesi kërkon mbështetje dhe një qasje shumë më reale, për njohjen e saj. Ndaj, kërkon një analizë të thuktë të krijimtarisë së gjithanshme figurative të tij. Duke e njohur krijimtarinë e tij, do ta vlerësonim dhe do ta çmoinim, si një arritje të mirëfilltë të këtij piktori i cili krijimtarinë e vet, shumë të bujshme e tregoi me një invencion të ravijëzuar dhe të ndiesuar, jashtë atdheut të tij në mërgim në Londër. Pra, krijimtaria e tij kërkon qasje reale, për ta njohur artin e tij dhe kreativitetin e tij ndiesor dhe fare përmbajtjesor.